



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prenjelo / Prodato Received / Delivery	28.09.2022	viti god year	2022
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMS/TK	5712/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.709/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Jeton Koca, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 709/2022, të datës 15.08.2022, së ankuesit me adrese banimi Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “ masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A. Nr.709/2022, e datës 15.08.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 15.08.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, me datë 10.08.2022 nga Mbikëqyrësja e Drejtpërdrejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 23.08.2022, ka bënë kërkesë për përgjigjen në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa më datë 06.09.2022, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka dërguara përgjigje në ankesë tek Këshilli.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 709/2022, e datës 15.08.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 4746/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-maili i datës 12.08.2022; kërkesë e datës 10.08.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2017, 2018, 2019, 2021; Vendimi i datës 09.02.2015, me numër protokoll 613; Vendimi i datës 15.01.2022, me numër protokoll 209/1; Përshkrimi i detyrave të Punës; Përgjigje në ankesë e datës 06.09.2022, me numër protokoll 5175/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pa lejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton e meqenëse ndaj ankuesit është iniciuar procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor, atëherë Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ka obligim ligjor që të shqyrtoj kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore dhe të nxjerr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, siç parashihet me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse ankuesi në ankesën e tij nuk ka sjell ndonjë akt administrativ me të cilin i është cënaur ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës, atëherë edhe parashtrimi i ankesës kundër iniciimit të procedurës disiplinore është e papranueshme, ndërsa ankesa parashtrohet kundër aktit administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik siç parashihet me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, i cili përcakton se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"*.

Bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër iniciimit të procedurës disiplinore pa pasur akt administrativ nga Komisioni Disiplinor e ka parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, si dhe nenin 24 paragrafi 3 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji"*, kështu që ankesa e ankuesit është e pa papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr. 709/2022

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI
Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

